

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E ENJTE 24 SHKURT 2022

E nderuara Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Në fakt, e marr fjalën pas diskutimeve të paraardhësve në këtë foltore, për të folur më lidhje me një çështje shumë të rëndësishme. Edhe unë vetë, si anëtare e Komisionit Hetimor, për shumë ditë dëgjova fjalë, akuza, por janë faktet dhe veprat ato që mbeten në fund. Në vitin 2013 vetëm 15, 6 % e mbetjeve depozitoheshin në landfill. Sot 70 % e mbetjeve të vendit shkojnë në një pikë fundore me kushte sanitare optimale, që është landfill djegës dhe prodhues energjie, thënë ndryshe impiant i menaxhimit të mbetjeve. Në vitin 2013 kishim vetëm dy vendtrajtime mbetjesh: në Bushat dhe në Sharrë. Pra, mbetjet nuk trajtoheshin në të gjithë Shqipërinë. Në vitin 2020 kemi pesë impiante trajtimi me kushte optimale sanitare, ndërsa shkalla e mbulimit me shërbime është 87, 9 %, nga 50, 5 % që ishte në vitin 2013. Sipas programit të ri të qeverisë, për periudhën 2021-2025 fusha e menaxhimit të mbetjeve është në krye të prioritetëve, kjo jo vetëm e një ministrie, por në fakt e tri ministrive, e gjithë qeverisë dhe e të gjithë shqiptarëve. Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për Arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për fëmijët, ka nisur hartimin e një plani të riciklimit, i cili do të zbatohet fillimisht në bashkinë e Tiranës e më pas në gjithë vendin. Plani i riciklimit synon të fillojë ndarjen e mbetjeve në burim dhe të riciklojë kryesisht mbetjet e plastikës dhe të letrës në shkollat e në institucionet publike.

Nëse sot nuk nisim betejën me ndryshimin e mentalitetit në trajtimin e plehrave, ne si qytetarë, ne si parlamentarë, ne si shqiptarë, luftën me mbetjet do ta kemi luftë shumë të gjatë. Prandaj ftesa është që të lexojmë siç duhet përpjekjet dhe punën e qeverisë në këta tetë vjet dhe të shikojmë objektivat e viteve që kemi përpara. Mbetjet kanë qenë aty edhe më parë. Emergjencat në qytetet e Elbasanit, Fierit, Tiranës, Durrësit, kanë qenë edhe përpara 2013-ës, por asnjë qeveri nuk i trajtoi me të njëjtën kurajë e me politika dhe procedura të sakta e të duhura si qeverisja e Kryeministrit Rama. Nuk u evidentua asnjëherë situata e emergjencës, por në rastin më të mirë u analizua me kosto më të lartë. Të debatosh sot koston 29 euro për ton, që është shumë e ulët në rajon, siç u pa dje nga të gjitha rastet që u sollën në komisioni parlamentar nga vetë Kryeministri Rama, por mbi të gjitha të mos shohësh me sy dy impiantet në qytetin e Fierit dhe në atë të Elbasanit, të cilët janë pronë apo do të jenë pronë e bashkive, në perceptimin më të thjeshtë është debat i pastër politik. Publiku e ka ndjekur vetë gjithë maratonën e diskutimeve, debatin e ditëve, shumën 430 milionë, e cila në fakt shkoi në 91, 9 milionë euro shpenzime të kryera, nga të cilat 55, 3 milionë euro janë shpenzime të buxhetit për të ndërtuar këto dy impiante, që shkuam e i pamë vetë. Ishin aty. Nuk janë fantazëm.

Pjesa tjetër prej 36, 6 milionë janë shpenzime shërbimi, shërbim për grumbullimin e plehrave në Tiranë, të ndodhura deri më sot. Objektivi i mbledhjes së këtyre plehrave është për të ndikuar në një jetë më të mirë për qytetarët në Tiranë, por jo vetëm. Tirana, Durrësi, Kavaja dhe të gjithë qytetet e Shqipërisë nuk do të jenë më qytete ku plehrat bëhen kapicë, ku emergjencat mjedisore mbeten

diskutime dhe debate nëpër të gjitha tryezat familjare, por mbi të gjitha janë një zgjidhje që do t'i jepet Shqipërisë jo vetëm për të gjithë qytetarët, jo vetëm për të gjithë vizitorët, jo vetëm për të gjithë investitorët, por mbi të gjitha për fëmijët tanë. E pikërisht për ta, për të ardhmen e tyre, vëmendja ndaj ambientit jo vetëm duhet analizuar, por duhet shtuar me vendime të tjera, të cilat ndihmojnë më tej për një qytet të pastër, për një Shqipëri të pastër. Më 1 qershor ne ndalojmë përdorimin e qeseve plastike për transport deri në 50 mikron. Ky vendim u përgëzua sot edhe nga Delegacioni i Parlamentit Europian, në Komitetin e Stabilizim-Asociimit. Shpresoj që vendime të tilla të merren në vijim. Shumë falemnderit!